



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI SHTETËROR I RINDËRTIMIT

V E N D I M

Nr. 22 datë 25.05.2020

Në mbështetje të Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të Vendimit nr.878, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen, organizimin e veprimtarive dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit”, Komisioni Shtetëror i Rindërtimit.

V E N D O S I:

1. Të miratojë si zonë të përshtatshme për zhvillim të detyruar, sipas hartës dhe koordinatave bashkëlidhur këtij vendimi, **Zonë të Re për Zhvillim** territorin prej 86,710m², në fshatin **Valias**, Bashkia Kamëz, për:
 - a. ndërtimin e **270 njësive të banimit në ndërtesa** (pallat), për akomodimin e familjeve të dëmtuara nga tërmeti në territorin e bashkisë,
 - b. rindërtimin e objekteve arsimore **shkollë** dhe **kopësht**,
 - c. ndërtimin e një **qendre administrative**,
 - d. për rehabilitimin e terreneve sportive dhe hapësirave publike.
2. Të miratojë si zonë të përshtatshme për zhvillim të detyruar, sipas hartës dhe koordinatave bashkëlidhur këtij vendimi, **Zonë të Re për Zhvillim** territorin prej 36,387m², në Njësinë Administrative **Rrëshen**, Bashkia Mirëditë, për:
 - a. ndërtimin e **120 njësive individuale të banimit**, sipas projekteve model të hartuara nga Enti kombëtar i Banesave, për akomodimin e 120 familjeve të dëmtuara nga tërmeti në territorin e kësaj njësie,
 - b. ndërtimin e një **qendre komunitare**.
3. Të caktojë Fondin Shqiptar të Zhvillimit, si “*njësi zbatuese*” sipas pikës 1 dhe 2 të këtij Vendimi në **Zonën e Re për Zhvillim**, në fshatin **Valias**, Bashkia Kamëz dhe në **Zonën e Re për Zhvillim**, në Njësinë Administrative **Rrëshen**, Bashkia Mirëditë për:
 - a) ndërtimin e banesave të reja ose të ndërtesave publike të dëmtuara;
 - b) ndërtimin dhe rikonstrukcionin e infrastrukturës publike e kritike,

- c) realizimin e ndërtimeve në këto zona;
- d) çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të këtyre zonave.

***Kostot operationale për Fondin Shqiptar të Zhvillimit do të përballohet nga Buxheti i Shtetit në përputhje me VKM nr 226, datë 21.03.2017, "Për financimin e kostos së menaxhimit të projekteve që zbatohen nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit"*

4.Të miratojë **rindërtimin në të njëjtin truall**, të njësive të banimit në **ndërtesa** (pallat), të vlerësuara "për shëmbje", referuar akt ekspertizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit, dhe kërkesës me nr. Prot. 961, datë 11.03.2020 të Bashkisë Mirëditë, për ndërtesat:

- a. Pallati 5 kat, nr. Pasurie 2/21, Rruga "At Gjergj Fishta", Rrëshen,
- b. Pallati 2 kat, nr. Pasurie 2/27, Rruga "At Gjergj Fishta", Rrëshen.

5.Të miratojë **rindërtimin në të njëjtin truall**, të njësive **individuale** të banimit, të vlerësuara "*për shëmbje*", referuar akt ekspertizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit, miratuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë **Kavajë** nr. 63, datë 23.05.2020 dhe përcjellë pranë KSHR-së me kërkesën me nr. Prot 1613, datë 23.05.2020 të Bashkisë Kavajë, për **110 ndërtesa** sipas listës bashkëlidhur. Rindërtimi në të njëjtin truall, në ndërtesa individuale banimi, do të bëhet sipas projekteve model të hartuara nga Enti Kombëtar i Banesave.

6.Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, së bashku me Bashkinë Kamëz, Mirëditë dhe Kavajë, pas miratimit të vendimit të KSHR-së, të fillojnë nga puna për hartimin e PDyV-ve për zonat e reja për zhvillim dhe zonat e dëmtuara pikësore, aty ku njësitë e banimit në ndërtesa (pallat) dhe ato individuale janë vlerësuar për "*shëmbje*" nga Instituti i Ndërtimit dhe miratuar nga Këshilli Bashkiak.

7.Ngarkohen Ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Kulturës, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, bashkitë Kamëz, Mirditë, Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KOMISIONIT SHTETËROR TË RINDËRTIMIT

Arben AHMETAJ

Sandër LLESHAJ

Anëtar

Besa SHAHINI

Anëtar

Bledar ÇUÇI

Anëtar

Olta XHAÇKA

Anëtar

Anila DENAJ

Anëtar

Elva MARGARITI

Anëtar

Blendi KLOSI

Anëtar

Belinda BALLUKU

Anëtar

Ogerta MANASTIRLIU

Anëtar